



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Laborator Teorik dhe Praktik për Shkrimin e Provës Finale

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 15 leksione / 45 seminare

Viti / Semestri : Viti II , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane për arsimin e mesëm të lartë”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Përvetësimi dhe zbatimi i kriterëve akademike të gjuhës së shkruar në përgjithësi dhe të temës finale në veçanti. Zhvillimi i aftësive për të hartuar tekste me një nivel të lartë shkrimor e duke respektuar standardet e shkrimit akademik. Aftësia për të sintetizuar, përmbledhur, krahasuar, deduktuar, në mënyrë autonome. Aftësia për të përpunuar literaturën shkencore me qëllim që të jenë në gjendje për të hartuar mbi këtë bazë temën e tyre finale.

Objektivat specifike lëndore:

1. Përvetësimi i veçorive leksikore, morfologjike, sintaksore të një teksti akademik.
2. Administrimi i informacionit në internet, redaktimi i i referencave bibliografike.
3. Zgjedhja e temave kërkimore shkencore që mund të ngjallin debate dhe të punuarit në mënyrë të pavarur dhe me iniciativë.
4. Analizimi i materialeve burimore: përdorimi dhe citimi në mënyrën e duhur të burimeve parësore dhe dytësore.

Rezultatet e pritshme :

1. Studenti do të jetë në gjendje të hartojë një tekst akademik të strukturuar dhe argumentuar, duke respektuar normat gjuhësore dhe kriteret shkencore të shkrimit universitar.
2. Studenti do të zotërojë aftësi për të kërkuar, përzgjedhur dhe përpunuar në mënyrë kritike burime shkencore, duke i cituar dhe referuar saktë sipas standardeve akademike.
3. Studenti do të jetë i aftë të formulojë dhe zhvillojë në mënyrë të pavarur një temë kërkimore, duke aplikuar strategji të mendimit analitik dhe sintetik për përfundimin e saj.